



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
REKTORATI

Nr. 2596 Prot.

Tiranë, më 04.10.2021

VENDIM

Nr.10, datë 01.10.2021

**PËR FILLIMIN E PLANIFIKIMIT DHE SHPËRNDARJES SË NGARKESËS  
MËSIMORE PËR PERSONELIN AKADEMIK ME KOHË TË PLOTË TË UT-së,  
PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022**

Në mbështetje të nenin 40, të nenit 59, të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; të nenin 19, pika 2, 3, të nenit 36, të neni 51, pika 1/b, të nenin 66, pika 6, të nenin 71, dhe të nenin 74, të Statutit të UT- së; të Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, të MASR, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar; të Vendimit nr. 119, datë 17.07.2019, të Bordit të Administrimit "Për miratimin e gjurmës së auditit për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Universitetin e Tiranës"; të programit mësimor të miratuar për çdo lëndë; Rektorati i UT-së, në mbledhjen e tij, të datës 01.10.2021,

**VENDOSI:**

1. Të fillojë planifikimi dhe shpërndarja e ngarkesës mësimore për personelin akademik me kohë të plotë, të çdo njësie bazë, për vitin akademik 2021-2022.
2. Ky Vendim përcillet në të gjitha njësitë në përbërje të Universitetit të Tiranës.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI  
Prof. Dr. Artan Hoxha

